



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK  
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE  
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 961/

Tirane, date 9.1.2015

Drejtuar: Z.VLADIMIR LAZAJ  
SHOQERIA "GORICA - INERTE" SH.P.K  
FSHATI DAMES, GODINA NJE KATESHE, KOMUNA FRATAR,  
MALLAKASTER

FIER

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV  
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE  
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR  
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE  
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1516 date 12.11.2010.

I nderuar z. Lazaj,

Shoqëria "Gorica - Inerte" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1516 date 12.11.2010, për gurë gëlqeror, komuna Fratar, Mallakastër, ne Qarkun Fier.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 2046 date 09.02.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.959 date 10.02.2015, është propozuar revokimi i lejes nr.1516 date 12.11.2010, për gurë gëlqeror, objekti "Fratar", ne Qarkun Fier, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2012 – 2013, për vitin 2013-2014 dhe për vitin 2014-2015.

Leja juaj është dhëne sipas procedurave te përcaktuara ne Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germen "ç" të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sa më sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes nr.1516 datë 12.11.2010, për gurë gëlqeror, komuna Fratar, në Qarkun Fier, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1516 datë 12.11.2010.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

**MINISTRI**

**DAMIAN GJIKNURI**

